



Në bazë të nenit 64 të Ligjit për Kulturë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 4/14, 61/15, 154/15, 39/16, 11/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 265/24), Ministria e Kulturës dhe Turizmit shpall

KONKURS PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE ME INTERES NACIONAL NË KULTURË ME ÇKA DO TË NXITET ZHVILLIMI I INDUSTRIVE KREATIVE NË VITIN 2025

I. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Ministria e Kulturës dhe Turizmit, për të mbështetur aktivitete që përfshijnë produksione kulturore ose artistike dhe lloje të tjera të produksioneve të bazuara në njohuri dhe aftësi, me qëllim të zhvillimit të dukshëm të turizmit, shpall Konkurs për financimin e projekteve me interes nacional në kulturë që do të nxisin zhvillimin e industrive kreative në vitin 2025 (në tekstin e mëtejme: Konkursi). Konkursi do të ofrojë mbështetje financiare për projekte për zhvillimin e industrive kreative (arkitekturë, arte vizuale, prezantim të krijimit të filmit, dizajn, art të aplikuar, trashëgimi kulturore, turizëm kulturor, letërsi, modë, muzikë, arte skenike dhe forma të ndryshme të shprehjes artistike digjitale).

Projektet duhet të realizohen brenda datës 31.11.2025.

Ministria e Kulturës dhe Turizmit në vitin 2025 do të mbështesë llojet e mëposhtme të projekteve që do të nxisin zhvillimin e industrive kreative (IK):

Llojet e projekteve	Vlera maksimale e mbështetjes financiare
1. Festivali i industrive kreative me kohëzgjatje të paktën 15 ditë (të drejtë për pjesëmarrje kanë vetëm komunat)	deri në 40% të vlerës së përgjithshme të projektit, me vlerë deri në 1.800.000 denarë
2. Festivali i industrive kreative i cili mbahet në vazhdimësi dhe deri më tani janë realizuar të paktën 10 edicione (të drejtë për pjesëmarrje kanë personat juridikë, me përjashtim të komunave dhe tregtar individual)	deri 1 200 000 denarë
3. Festivali i industrive kreative i cili mbahet në vazhdimësi dhe deri më tani janë realizuar të paktën 5 edicione (të drejtë për pjesëmarrje kanë personat juridikë, me përjashtim të komunave dhe tregtar individual)	deri 600 000 denarë
4. Festivali/panairi/manifestimi i industrive kreative (të drejtë për pjesëmarrje kanë	deri 400 000 denarë

personat juridikë, me përjashtim të komunave dhe tregtar individual)	
5. Përpunimi i koleksionit/serisë ë produkteve të ndryshme kreative/artistike me ekspozitë/prezantim të produkteve (të drejtë për pjesëmarrje kanë personat fizik dhe tregtarë individual)	deri 100 000 denarë
6. Organizim të konferencës/forumit nga fusha e industrive kreative (të drejtë për pjesëmarrje kanë personat juridikë, me përjashtim të komunave dhe tregtar individual)	deri 500 000 денари

VËREJTJE:

- **Ministria e Kulturës dhe Turizmit nuk do të financojë projekte në të cilat industria kreative dhe kulturore, si në aspektin programor ashtu edhe në atë konceptual, nuk janë baza e projektit.**
- **Ministria e Kulturës dhe Turizmit nuk do të financojë projektet e realizuara në kafene, restorante, disko-klube dhe kazino.**
- **Ministria e Kulturës dhe Turizmit nuk do të financojë: shpenzime për shërbime komunale, të kontabilitetit dhe të telekomunikacionit; shpenzime për shërbime të taksive dhe transport ditor; shpenzime për marrjen me qira të hapësirës së punës (zyre, punëtori, studio...), anëtarësi si dhe për furnizimin (blerjen) e pajisjeve teknike dhe mobileve.**

II. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE NË KONKURS

- Të drejtë për pjesëmarrje në konkurs kanë: personat fizikë, shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut; personat juridikë dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale. Personat juridikë përfshijnë institucionet kulturore (lokale ose private), njësitë e vetëqeverisjes lokale, shoqatat, lidhjet, asociacionet, shoqëritë tregtare, tregtarët individualë dhe personat e tjerë juridikë të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtim me ligjin.
- Qyteti i Shkupit, komunat në qytetin e Shkupit, institucionet nacionale dhe lokale nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurs.
- Pjesëmarrësi në Konkurs që ka pasur projekte të mbështetura nga Ministria e Kulturës dhe Turizmit në vitet e mëparshme duhet t'i përmbush të gjitha obligimet në pajtim me marrëveshjet e lidhura me Ministrinë e Kulturës dhe Turizmit. Fletëparaqitjet e dorëzuara në Konkurs nga pjesëmarrës që nuk i kanë përmbushur të gjitha obligimet në pajtim me marrëveshjet e lidhura me Ministrinë e Kulturës dhe Turizmit, nuk do të merren parasysh.

Personat juridikë dhe fizikë mund të marrin pjesë në konkurs vetëm me një projekt.

Dokumentacioni i obligueshëm i kërkuar që e vërteton plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta është paraqitur më poshtë në këtë konkurs.



Nuk do të shqyrtohen këto fletëparaqitje:

- që janë dorëzuar pas afatit të përcaktuar në Konkurs;
- që nuk korrespondojnë me llojin e projektit;
- që janë dërguar në adresat elektronike të punonjësve të Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit;
- që nuk janë të plotësuara të plota (të gjitha kolonat duhet të plotësohen me të dhënat përkatëse);
- për të cilat në shtojcë nuk është dorëzuar dokumentacioni i obligueshëm, i përcaktuar në këtë konkurs.

III. PRIORITETET

Në mënyrë që projekti të vlerësohet nga komisioni profesional, projekti i paraqitur duhet të përmbushë të paktën 4 (katër) nga prioritetet e mëposhtme, në pajtim me llojin e projektit:

1. Projektet që i shërbejnë qëllimit të promovimit të industrive kreative me shikueshmëri të lartë në publik;
2. Projektet që nxisin turizmin kulturor dhe llojet e tjera të turizmit në vend;
3. Projektet që shërbejnë për të mbështetur praktikuesit kreativ (së bashku dhe/ose individualisht) si faktor fokusi në zhvillimin e industrive kreative;
4. Projektet që kontribuojnë në popullarizimin e trashëgimisë natyrore dhe/ose kulturore të identifikuar dhe në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm;
5. Projektet që kontribuojnë në ruajtjen dhe ushtrimin e zejeve tradicionale, veçanërisht të atyre që janë të rrezikuara;
6. Projektet që kontribuojnë në popullarizimin e gastronomisë tradicionale maqedonase dhe/ose verërave maqedonase;
7. Mbështetje për konferencë/forum në fushën e industrive kreative me përfshirjen e ekspertëve ndërkombëtarë dhe vendas;
8. Prodhimi i produkteve origjinale kreative në fushën e arteve të aplikuara;
9. Krijimi i produkteve dhe aktiviteteve që kanë ndikim të përkohshëm/mesëm/afatgjatë dhe kontribut ekonomik për komunitetin dhe sektorët përkatës;
10. Projekte që integrojnë praktikën e gjelbra nëpërmjet aktiviteteve kulturore për të rritur ndërgjegjësimin për kulturë të përgjegjshme ndaj mjedisit;
11. Projektet e realizuara në bashkëpunim me një komunë dhe/ose partner/fondacion/sponsor;
12. Projektet që janë në funksion të qasjes dhe përfshirjes së komunitetit, grupeve të ndryshme dhe publikut në aktivitetet e projektit;
13. Projekte me potencial për të krijuar ose përmirësuar aktivitete kulturore të rëndësishme për komunitetin, duke pasuruar skenën kulturore lokale nëpërmjet zgjidhjeve inovative dhe kreative.

IV. KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË KONKURS

Në mënyrë që projekti të vlerësohet nga komisioni profesional, parashtruesi duhet t'i plotësojë kërkesat e mëposhtme:

A) KUSHTET E PËRGJITHSHME

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut (për persona fizikë).
- Të jetë i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me përjashtim të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe subjekteve të tjera juridike të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut (për personat juridikë).
- Duhet të ketë dokument që konfirmon pjesëmarrjen e pjesëmarrësve dhe bashkëpunëtorëve të përmendur në projekt.
- Të ketë hapësirë për zbatimin e projektit.
- Të ketë të drejta të rregulluara të autorit (nëse nga projekti del obligimi për të rregulluar të drejtat e pronësisë intelektuale (të drejtat e autorit ose të pronësisë industriale).
- Të ketë marrëveshje bashkëpunimi (nëse projekti zbatohet në bazë të bashkëpunimit të dakorduar ose nëse është kërkesë e veçantë sipas llojit të projektit).
- Të ketë portofol për bartësin e projektit, me përjashtim të komunave.

B) Kushtet e veçanta sipas llojeve të caktuara të projektit

Parashtruesi i projektit në fushën e industrive kreative dhe kulturore duhet të plotësojë plotësisht kushtet e veçanta të specifikuara:

- 1. Festival të industrive kreative (të drejtë për pjesëmarrje kanë komunat), deri në 40% të shumës së përgjithshme të projektit, me shumë maksimale të mbështetjes financiare deri në 1.800.000 denarë**
Parashtruesi duhet:
 - të paraqesë program të hollësishëm të festivalit me pjesëmarrës, i cili do të zgjasë të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë në vitin 2025.
- 2. Festival të industrive kreative që mbahet në vazhdimësi dhe deri më tani janë realizuar së paku 10 edicione (të drejtë për pjesëmarrje kanë personat juridikë, me përjashtim të komunave dhe tregtar individual), me shumë maksimale të mbështetjes financiare deri në 1.200.000 denarë**
Parashtruesi duhet:
 - të ketë vazhdimësi në organizimin profesional të festivalit në fushën e industrisë kreative dhe kulturore për mbi 10 (dhjetë) vjet;
 - të paraqesë program të hollësishëm të festivalit me pjesëmarrës, i cili do të zgjasë më shumë se 7 (shtatë) ditë në 2025.
- 3. Festival të industrive kreative që mbahet në vazhdimësi dhe deri më tani janë realizuar së paku 5 edicione (të drejtë për pjesëmarrje kanë personat juridikë, me përjashtim të**



komunave dhe tregtar individual), me shumë maksimale të mbështetjes financiare deri në 600.000 denarë

Parashtruesi duhet:

- të ketë vazhdimësi në organizimin profesional të festivalit në fushën e industrisë kreative dhe kulturore për më shumë se 5 (pesë) vjet, i cili ka zgjatur të paktën 3 (tri) ditë;
- të paraqesë program të hollësishëm të festivalit me pjesëmarrës, i cili do të zgjasë të paktën 3 (tre) ditë në 2025.

4. Festival/panair/manifestim të industrive kreative (të drejtë për pjesëmarrje kanë personat juridikë, me përjashtim të komunave dhe tregtar individual), me shumë maksimale të mbështetjes financiare deri në 400.000 denarë

Parashtruesi duhet:

- të ketë vazhdimësi në organizimin profesional të projekteve/veprimtarive në fushën e industrive kreative dhe kulturore për më shumë se 2 (dy) vjet;
- të paraqesë program të hollësishëm me pjesëmarrës, i cili do të zgjasë të paktën 2 (dy) ditë në vitin 2025.

5. Përpunim të koleksionit/serisë së produkteve të ndryshme dhe ekspozimi/prezantimi i produkteve (të drejtë për pjesëmarrje kanë personat fizik dhe tregtarët individual), me shumë maksimale të mbështetjes financiare deri në 100.000 denarë

Parashtruesi duhet:

- të ketë marrë pjesë në të paktën 1 (një) ekspozitë/panair/manifestim/festival publik në fushën e industrisë kreative dhe kulturore;
- të paraqesin koncept dhe material vizual për produktet kreative.

*** Ministria e Kulturës dhe Turizmit do të sigurojë hapësirë për prezantimin e produkteve kreative.**

6. Organizim të konferencës/forumit nga lëmi i industrive kreative (të drejtë për pjesëmarrje kanë persona juridikë, me përjashtim të komunave dhe tregtar individual), me shumë maksimale të mbështetjes financiare deri në 500.000 denarë

Parashtruesi duhet:

- të ketë vazhdimësi në organizimin profesional të ndonjë konference/forumi në fushën e industrive kreative dhe kulturore për më shumë se 3 (tre) vjet, në të cilën kanë marrë pjesë ekspertë ndërkombëtarë dhe vendas;
- të paraqesë koncept dhe listë të pjesëmarrësve.

V. KRITERET DHE MATËSIT NË BAZË TË TË CILËVE DO TË BËHET VLERËSIMI I PROJEKTEVE

Komisioni profesional do të vlerësojë projektet bazuar në kriteret e mëposhtme:

1. Cilësia e përmbajtjes së projektit.
2. Burimet njerëzore.
3. Arsyetimi financiar.

Kriteret e mësipërme do të vlerësohen sipas matësve të mëposhtëm:

1. Cilësia e përmbajtjes ë projektit- gjithsej 50 pikë

Cilësia e përmbajtjes së projektit do të vlerësohet përmes kreativitetit, origjinalitetit, ndikimit të pritur, rëndësisë, inovacionit, dukshmërisë.

2. Burimet njerëzore – gjithsej 30 pikë

Burimet njerëzore do të vlerësohen përmes arritjeve artistike ose profesionale të drejtuesve dhe pjesëmarrësve të projektit, përvojës në fushën përkatëse, mirënjohjeve, çmimeve, vlerësimeve pozitive për arritjet e mëparshme.

3. Arsytimi financiar – gjithsej 20 pikë

Arsytimi financiar duhet të shprehë projektionin real të shpenzimeve të përgjithshme për zbatimin e projektit si dhe baraspeshën reale ndërmjet honorarëve dhe shpenzimeve të tjera për zbatimin e projektit.

VI. PËRQINDJA E PJESËMARRJES SË MINISTRISË SË KULTURË DHE TURIZMIT NË FINANCIMIN E PROJEKTEVE

Përqindja e pjesëmarrjes së Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit në financimin e projekteve është në pajtim me mjetet e parapara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2025 për financimin e projekteve me interes nacional sipas fushave dhe aktiviteteve të veçanta.

VI. MËNYRA E FINANCIMIT

Për t'u përzgjedhur dhe financuar si projekt me interes nacional në kulturë, projekti duhet të marrë të paktën 51 pikë, nga gjithsej 100 pikë, në pajtim me kriteret dhe matësit mbi bazën e të cilave janë vlerësuar projektet.

Ministria e Kulturës dhe Turizmit do të marrë pjesë në financimin e projektit me së paku 51% të mjeteve në shumën maksimale në denarë të përcaktuar sipas llojeve të projekteve nga Kreu I i këtij konkursi.

Si përjashtim, nëse projekti merr të paktën 51 pikë kurse fondet e kërkuara janë më të ulëta se shuma prej 51% e mjeteve që duhet miratuar, Ministria e Kulturës dhe Turizmit rezervon të drejtën të marrë pjesë në financimin e projektit, por jo në një shumë më të madhe se shuma e kërkuar nga përfituesi.

VI. AFATI I DORËZIMIT TË FLETËPARAQITJEVE

Afati i fundit për paraqitjen e fletëparaqitjeve për projekte për zhvillimin e industrive kreative është nga data 28.3.2025 deri më 28.4.2025 deri në orën 15:30.

VII. INFORMACIONE TJERA

1. Mënyra e aplikimit:

Fletëparaqitjet dorëzohen në arkivin e Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit.

2. Njoftimi i rezultateve të Konkursit: Aplikuesit do të njoftohen për rezultatet e Konkursit në pajtim me Ligjin për Kulturë. Rezultatet e Konkursit do të publikohen edhe në faqen e Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit.



Rezultatet e publikuara do të përmbajnë informacion për bartësin e projektit, titullin e projektit dhe mjetet e miratuara për zbatimin e projektit.

3. Informacione shtesë

Informacione shtesë profesionale në lidhje me Konkursin mund të merren në adresën e mëposhtme elektronike: arlind.huseini@kultura.gov.mk

